



Vlerësim Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional të
Universitetit të Arteve**

Maj 2017

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|--------------------------|---------|
| 1 | Profesor Edward J Esche | Kryetar |
| 2 | Dr. Heather Barrett-Mold | Anëtare |
| 3 | Profesor Sherif Bundo | Anëtar |
| 4 | Dr. David Taylor | Anëtar |

Datë: 15-16 Maj 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi.....	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	12
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	16
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	20
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre.....	24

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga QAA-UK dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush Standardet . Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatohet për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet . Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupin e Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Arteve (UA) është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë që përqendrohet tërësisht tek artet. Ai ofron diploma Bachelor, Master i Shkencave, Master i Arteve dhe Master Profesional në Muzikë, Artet e Bukura dhe Artet Dramatike. Është themeluar në vitin 1966 si Instituti i Lartë i Arteve duke bashkuar tre institucione artistike: Konservatorin Shtetëror të Tiranës, Shkollën e Arteve të Bukura dhe Shkollën e Lartë të Aktorëve Aleksandër Moisiu. Në vitin 1990 u bë Instituti i Lartë i Arteve me nivel universitar të njohur nga qeveria dhe që nga viti 2011, Universiteti i Arteve (UA) përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Artit Dramatik; Fakulteti i Arteve të Bukura; dhe Fakulteti i Muzikës. Ai ofron programe të cilat mbështeten nga kërkimi dhe veprimtaritë profesionale performuese në fushat e mëposhtme: muzikë, që përfshin interpretimin, kompozimin, muzikologjinë, dirigjimin, mësuesinë; artin dramatik, që përfshin aktrimin dhe teorinë, skenografi-koreografi, regji teatri, regji filmi dhe televizioni; dhe artet e bukura, që përfshijnë pikturën, skulpturën dhe artin e aplikuar.

UA ka lidhur një gamë të gjerë marrëveshesh me institucionet e artit profesional, si Radio Televizioni Shqiptar, Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit të Shqipërisë, Teatri Kombëtar i Shqipërisë dhe bizneset dhe institucionet vendore për të krijuar dhe promovuar marrëdhënie të efektshme mes kërkimit shkencor, prodhimit krijues dhe interesave të komunitetit. Ai ndjek një politikë aktive të pjesëmarrjes në projekte artistike ndërkombëtare me institucione në Evropë dhe më gjerë, që pasqyron misionin dhe vizionin e tij për të mbështetur, përmirësuar dhe zgjeruar jetën kulturore shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

Raporti i përmbledhur

UA është një institucion publik me ambientet dhe ndërtesat e veta të vendosura në Tiranë. Ai ofron programet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë që ofrohen në gjuhën shqipe. Tre fakultete përbëjnë Universitetin: Fakulteti i Artit Dramatik; Fakulteti i Arteve të Bukura; Fakulteti i Muzikës. Misioni i tij është të ofrojë arsim profesional artistik dhe të realizojë projekte artistike dhe shkencore në fushën e muzikës, artit dramatik, dhe artit pamor dhe të aplikuar duke mbështetur fuqishëm ruajtjen e traditës së të shkuarës dhe duke siguruar një nivel më të lartë cilësie në të gjitha fushat ku vepron institucioni. Në 2016-2017, UA kishte 993 studentë të regjistruar në programet me kohë të plotë.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) u hartua nga një grup prej 18 personash në UA ku u përfshinë drejtuesit e lartë, stafi akademik, personeli mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve. Fakultetet individuale krijuan grupe pune dhe projekt raportet u qarkulluan brenda institucionit para se t'i dorëzoheshin Rektorit për miratim përfundimtar. Cilësia e raportit të vetëvlerësimit ishte e dobët. Shumë shpesh nuk referoheshin detaje të mjaftueshme, gjë që do të thoshte se Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mund të vlerësonte ose të shqyrtonte lehtë pohimet dhe deklaratimet shumë të përgjithshme që ishin bërë. Gjithashtu, vlerësuesit britanikë nuk ishin në gjendje të lexonin shumë nga provat e siguruar, sepse shumica e tyre nuk u përkthyen në gjuhën angleze.

Vizita u zhvillua gjatë dy ditëve më 15 dhe 16 maj 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i përbërë nga tre vlerësues të lartë të arsimit të lartë nga Britania dhe një anëtar stafi me përvojë nga një institucion shqiptar i arsimit të lartë, i cili nuk fliste anglisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Drejtuesi i Vlerësimit dhe një person për mbajtje shënimesh siguruar nga Agjencia (Shqiptare) Publike e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori një raport të vetëvlerësimit dhe dosjen e provave dhe dokumentacionit mbështetës tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, e plotësuar më vonë me dokumentacion shtesë të kërkuar. Në tërësi, u siguruan 587 dokumente që t'i mundësonin grupit i vlerësimit që të njihet me strukturën, politikën, procedurat e administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga UA. Dokumentacioni përfshinte Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listat e memorandumëve dhe marrëveshjeve të jashtme, shembuj të informacioneve të programit dhe dokumentacion nga diskutimet e mbledhjeve.

Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe personelin mbështetës, si dhe partnerët e jashtëm, punëdhënës dhe alumni. Diskutimi mbështeti sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Janë marrë shënime në të gjitha takimet nga pjesëmarrësit britanikë dhe shqiptarë. Si pjesë e një vizite në kampus, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, ambientet e performimit, një galeri dhe zyra. Ata gjithashtu panë një demonstrim të sistemeve të informacionit online dhe elektronik të UA.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë plotësuar plotësisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi veçoritë e praktikës së mirë dhe asnjë dobësi. Organizimi efikas dhe debati i hapur ilustron funksionimin kolegjal. Plani Strategjik është në përputhje me misionin dhe vizionin e UA-së që të mbetet qendra më e madhe dhe më e mirë e arsimit universitar, kërkimit dhe trajnimit profesional për specialistët e arteve në Shqipëri, edhe pse sfidat financiare mbeten të konsiderueshme. Zhvillimet e ardhshme përfshijnë hapjen e ciklit të tretë të studimeve dhe programeve të ndryshme të reja për të trajtuar mundësitë e punësimit për studentët të cilët nuk do të kenë sukses në nivelet më të larta të përpjekjeve artistike. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë rrjetin e bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve të gjera që trajtojnë ekselencën artistike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë ato që ofrojnë shërbime për studentët dhe ndihmojnë UA-në.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë dhe një Standardi që nuk është përmbushur plotësisht, **Kapitulli III Standardi IV.3**, por kjo nuk paraqet ndonjë rrezik serioz për administrimin e kësaj fushe. UA administron me kompetencë burimet financiare dhe materiale për të ofruar kualifikim cilësor në arte për studentët. Praktikrat e mira të identifikuara janë se i gjithë stafi akademik dhe mbështetës janë të përfshirë në veprimtarinë artistike jashtë UA, e cila kontribuon në jetën shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë, dhe disponueshmërinë e favorshme të një arkivi të gjerë të veprimtarive historike, që u mundëson studentëve të kenë akses në punën e studentëve të mëparshëm, si dhe në filmat dhe muzikën e filmave shqiptarë. Ka një dobësi lidhur me mungesën e vullnetit dhe dëshirës në përgjithësi për të reflektuar mbi metodologjinë e mësimdhënies, dhe nuk ka një trajnim specifik në metodat e mësimdhënies, përveç qasjes së të mësuarit nga të tjerët dhe fillimit të përvojës së mësimdhënies nëpërmjet seminareve. Grupi i vlerësimit, pra, rekomandon që UA të krijojë një plan për përmirësimin afat shkurtër dhe të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe ta zbatojë atë.

Standardet për Kurrikulën përmbushen kryesisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë dhe dy Standarde që nuk përmbushen plotësisht, **Kapitulli I Standardi I.5 dhe Kapitulli I Standardi I.12**, por kjo nuk paraqet ndonjë rrezik serioz për administrimin e kësaj fushe. Misioni i UA është i përqendruar në kualifikimin profesional artistik dhe realizimin e projekteve artistike dhe shkencore në fushën e muzikës, artit dramatik dhe artit pamor dhe të aplikuar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktika të mira në përqendrimin e vizionit të UA që i kishte si stafi edhe studentët në të gjithë institucionin, dhe mundësitë për praktikë të hershme në skenë, që u mundësojnë studentëve të fitojnë përvojë në performim në një mjedis profesional. Paaftësia për të paguar lektorët me kohë të pjesshme në kohën e duhur është një dobësi që ka çuar në vështirësi të mëdha në organizimin e programeve të studimit dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UA të ndërmarrë hapa për të siguruar pagesën e të gjithë stafit në përputhje me detyrimet kontraktuale. Nuk ka ndonjë trajnim të rëndësishëm për një karrierë të ndryshme nga ajo e një artisti profesionist, që është një dobësi, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UA të rishikojë plan-programin e vet për të ofruar më shumë aftësi të transferueshme për karrierë.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës të mirë dhe asnjë dobësi. Programet e studimit të studentëve janë organizuar në mënyrë efikase dhe përcaktohen me rregulloret e UA-së. Kërkimi shkencor në kontekstin specifik të UA-së është barazuar në krijimtarinë artistike ndërsa prurjet janë organizuar në nivel departamenti. Praktika e mirë përfshin rekrutimin e artistëve dhe interpretuesve të cilësisë më të lartë në vend për të mbështetur veprimtarinë mësimore dhe kërkimore. UA krijon mundësi për stafin akademik dhe studentët në të gjitha nivelet, për të realizuar dhe prezantuar idetë, talentet, projektet dhe krijimtarinë e tyre. Ai ofron objekte, salla, staf, instrumente, skena, hapësira dhe infrastrukturë për këto qëllime. Fakti që stafi akademik prodhon punë krijuese në nivel ndërkombëtar gjithashtu përfaqëson një praktikë të mirë.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre përmbushen plotësisht. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy praktika të mira dhe asnjë dobësi. Praktika e mirë përfshin raportin e mentorimit student individual/lektor që vazhdon përgjatë programit të çdo studenti, por edhe përtej diplomimit kur artistët zhvillojnë karrierën e tyre, dhe veçanërisht mbështetjen e mirë të karrierës që ofron UA për studentët e vet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon seksionin e Menaxhimit të Informacionit të punës fillestare të UA për të mbledhur statistika dhe të dhëna mbi punësimin e studentëve përmes mediave sociale, dhe planet për të zhvilluar më tej procesin aktual të pa plotë për të përfshirë të gjithë studentët e diplomuar. Studentët folën ngrohtësisht se janë të rrethuar nga një mori praktikash dhe kulturash artistike.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrit në përfundimin se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht në tre fusha dhe janë përmbushur kryesisht në dy fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet dhe marrëveshjet e gjera që promovojnë ekselencën artistike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare (pika 1.15, **Kapitulli III Standardi III.3**, **Kapitulli III Standardi III.4**)
- i gjithë stafi akademik dhe personeli mbështetës janë të përfshirë në veprimtarinë artistike jashtë UA që kontribuon në jetën shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- disponueshmëria e lehtë e një arkivi të gjerë të veprimtarive historike që u mundëson studentëve të kenë akses në punën e studentëve të mëparshëm, si dhe në filmat dhe muzikën e filmave shqiptarë (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi VII.4**)
- përqendrimi në vizionin e UA që e kanë si stafi dhe studentët në gjithë universitetin (pika 3.1, **Kapitulli I Standardi I.1**)
- mundësitë për praktikë të hershme në skenë, që u mundëson studentëve të fitojnë përvojën e performancës në një mjedis profesional (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.11**)
- rekrutimi i artistëve dhe interpretuesve të cilësisë më të lartë në vend për të mbështetur veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të UA (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- stafi akademik prodhon punë krijuese në nivel ndërkombëtar (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- marrëdhëniet e mentorimit të studentëve individualë me lektorët që vazhdojnë përgjatë programit të çdo studenti, edhe përtej diplomimit kur artistët zhvillojnë karrierën e tyre (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.3**)
- mbështetja veçanërisht e mirë e karrierës që ofron UA për studentët e vet (pika 5.11, **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e trajnimeve të vazhdueshme dhe efikase për stafin akademik në metodat e mësimdhënies (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.3**)
- pamundësia për të paguar lektorët me kohë të pjesshme në kohën e duhur gjatë kohëve të fundit, gjë që ka çuar në vështirësi të mëdha në organizimin e programeve të studimit (pika 3.6, **Kapitulli I Standardi I.5**)
- nuk ka ndonjë trajnim të rëndësishëm për një karrierë të ndryshme nga ajo e një artisti profesionist (pika 3.13; **Kapitulli I Standardi I.12**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të krijojë dhe zbatojë një plan për përmirësimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.3**)
- për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar pagesën e të gjithë stafit në përputhje me detyrimet kontraktuale (pika 3.6, **Kapitulli I Standardi I.5**)

- për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të rishikojë plan programin e vet për të ofruar më shumë aftësi të transferueshme karriere (pika 3.13; **Kapitulli I Standardi I.12**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme që po ndërmerren:

- Hapat që merren nga Seksioni i Menaxhimit të Informacionit të UA për të zhvilluar më tej procesin aktual të paplotë të mbledhjes së statistikave dhe të të dhënave të punësimit të studentëve për të përfshirë të gjithë studentët e diplomuar (pika 5.11).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
3. Standardet për kurrikulën janë **përbushur kryesisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Universitetin e Arteve, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raport i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja dhe kuadrot rregullatorë të Universitetit të Arteve (UA) janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe në përputhje me objektivat dhe misionin e tij. Ai funksionon në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ndryshimeve përkatëse, si institucion publik i arsimit të lartë sipas 125 neneve të statutit të vet të brendshëm dhe 86 neneve të rregulloreve të studimeve për dy ciklet. **[RVV fq.7; 1.0; 1.2; 1.3]** UA gjithashtu ka rregullore të brendshme shtesë në nivel Fakulteti. **[RVV fq.7; 3.33]** Institucioni përditëson rregullisht statutin dhe rregulloret e veta sipas rrethanave që ndryshojnë, ku rasti më i fundit është riorganizimi i departamenteve në Fakultetin e Arteve Skenike. **[RVV fq.7; 1.1, fq.3-4]** UA pranon se do të duhet të përditësojë Statutin dhe Rregulloret e veta më tej si rezultat i ligjit të ri nr. 80/2015, datë 07.09.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". **[RVV fq.7] [Kapitulli III Standardi 1.1]**

1.2 UA drejtohet në mënyrë efikase. Statuti ofron udhëzime për administrimin e UA dhe Rregullorja ofron udhëzime për administrimin e tij. **[RVV fq. 8; 1.0; 1.2; 1.3]** Organet e brendshme të drejtimit janë Senati Akademik, Këshilli i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Këshilli i Profesorëve, Këshilli i Fakultetit dhe Këshillat e Departamenteve **[RVV fq.7-8; 1.1 Nenet 9-36; M11]** Autoritetet drejtuese të UA-së janë Rektori, Zëvendës Rektorët, Dekanët e Fakulteteve, Zëvendës Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Departamenteve. **[RVV fq. 8; 1.1 Nenet 38-49, 54-56]** Rektori, dekanët dhe përgjegjësit e Departamenteve zgjidhen me votim të fshehtë; i pari nga të gjithë anëtarët e UA duke përfshirë studentët, të dytët nga të gjithë anëtarët e fakultetit përkatës duke përfshirë studentët dhe të fundit vetëm nga stafi akademik i departamentit përkatës. Grupet e ndryshme kanë pesha të ndryshme në numërim: Votimi i stafit akademik ka gjithmonë vlerën e 1 vote, votat e studentëve kanë vlerën .2 dhe votat e personelit jo akademik llogariten me vlerën .05 **[1.1 Nenet 40.1, 40.3, 44.1, 44.3, 48.1]** Pas marrjes së kërkesave dhe informacioneve nga të gjitha zyrat dhe departamentet e UA, Rektorati harton buxhetin dhe e propozon atë në Senatin Akademik ku diskutohet dhe miratohet me shumicën e votave të anëtarëve. **[RVV fq.7; 1.1 Statuti i UA, Nenet 9, 2.c dhe 18, 1.d; M3; M4; M15]** Pastaj i dërgohet Këshillit të Administrimit për miratim përfundimtar me shumicë prej dy të tretave dhe më pas dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. **[1.1 Statuti i UA, Neni 20, 2.b] [Kapitulli II Standardi I.2]**

1.3 Tre fakultetet dhe nëntë departamentet funksionojnë në frymën e lirisë akademike. **[1.1 Neni 6]** Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendim marrës brenda secilit fakultet. Ai mbikëqyr një sërë veprimtarish bazuar në propozimet e departamenteve, duke përfshirë ato për përdorimin e burimeve njerëzore dhe materialeve, për programet e reja të studimit dhe për kërkim shkencor. Ai gjithashtu mbikëqyr ndryshimet e departamenteve, administrimin financiar, përgatitjen e raportit vjetor dhe planin strategjik të zhvillimit. **[RVV fq. 8; 1.1 Nenet 31-34]** Këshilli i Profesorëve aktualisht nuk funksionon për shkak të ligjit të ri. **[M2] [Kapitulli II Standardi I.2]**

1.4 Organet kolegjiale, si Këshilli i Administrimit dhe Këshilli i Etikës në nivel universitar, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Profesorëve në nivelin e fakultetit, mbledhen në mënyrë periodike dhe diskutojnë dhe debatojnë në mënyrë konstruktive për çështje që lidhen me një sërë aspektesh të rëndësishme universitare, përfshirë buxhetin, Planin Strategjik dhe Raportin Vjetor. Ata gjithashtu debatojnë çështje të tjera vendore, siç janë ngarkesa e mësimdhënies, detyrat e lektorëve të ftuar dhe ndryshimet jo-thelbësore të kurrikulës. **[RVV fq.13; 1.1 Nenet 20-36; B.4 pikat 5 dhe 6; M11]** Një propozim që kërkon veprim zakonisht nis procedurën Këshillin e Departamentit, më pas kalon tek Këshilli i Fakultetit dhe më pas

në Senatin Akademik. **[M4; M11; M15]** Këshilli i Administrimit dhe Senati Akademik mbledhen një herë në muaj; **[RVV fq. 9; 1.1 Nenet 13.1, 24.1]** Rektorati mbledhet të paktën një herë në dy javë. **[1.1 Neni 13.1]** Axhenda dhe materialet e mbledhjes për diskutim u vihen në dispozicion pjesëmarrësve të paktën shtatë ditë përpara mbledhjes, në rastin e Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit **[RVV fq. 9; 1.1 Nenet 13.3, 24.3]** dhe së paku tri ditë para mbledhjes në rastin e Këshillit të Fakultetit. **[1.1 Neni 34.2]** Nenet nuk përmendin ndonjë proces monitorimi për vendimet e marra në mbledhje lidhur me veprimet që do të ndërmerren. **[1.1 Nenet 9-27, 31-34]** Stafi tha se ata përdorin plane veprimi, **[M2; M11]**, por provat e ofruara nuk janë një plan veprimi. Procesverbalet janë në gjuhën shqipe dhe prandaj është e pamundur të kontrollohen forma të tjera të monitorimit. **[C.6] [Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3]**

1.5 Ekzistojnë një numër mekanizmesh të brendshëm që sigurojnë funksionimin efikas dhe monitorimin e UA-së brenda kufijve të vet autonom, përfshirë funksionet drejtuese të Zëvendës Rektorëve dhe Zëvendës-dekanëve, grupeve të punës për secilin fakultet për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë, dhe një nen i veçantë në Statutin e vet. Neni përshkruan vetëqeverisjen e UA-së, organizimin e strukturave dhe veprimtarive të tij të brendshme, hartimin e programeve studimore dhe projektet kërkimore, si dhe të drejtën për të mbledhur fonde dhe për të bërë marrëveshje të pavarura. **[RVV fq. 9-10; 1.1 Neni 2.1.a-2.1.d]** UA nuk ka angazhuar konsulentë të jashtëm për të ndihmuar në funksionimin e përshtatshëm të tij. **[RVV fq.9]** UA organizohet në mënyrë të tillë që t'i japë mundësi vetes të përfitojë nga skemat e BE-së (shih pikat 1.13 dhe 3.1) **[RVV fq.9] [Kapitulli III Standardi I.4]**

1.6 Plani Strategjik i UA-së me Nëntë Pjesë është i harmonizuar mirë me misionin dhe vizionin e tij institucional. **[RVV fq.10; 1.4; 1.1 Neni 3]** Rektori udhëhoqi punën për përgatitjen e tij, dhe pati pjesëmarrje të gjerë dhe përfshirje nga organet drejtuese, drejtuesit e fakultetit, stafi akademik, stafi jo akademik dhe studentët. **[M3; M13]** UA ka një vizion strategjik që të mbetet qendra më e madhe dhe më e mirë e arsimit universitar, kërkimit shkencor dhe kualifikimin profesional për specialistët e arteve në Shqipëri, dhe të pozicionohet në mënyrë të favorshme në një perspektivë më të gjerë ndërkombëtare. **[1.4 fq.2, fq.7; M3]** Disa nga prioritetet e shprehura në Planin Strategjik janë sigurimi i cilësisë, bashkëpunimi ndërkombëtar, kompozimi artistik, kërkimi shkencor dhe partneritetet ndërkombëtare. **[1.4 fq.14-23]** UA në mënyrë të përsëritur i theksoi grupit të vlerësimit se, megjithatë, realizimi i strategjisë së zhvillimit është penguar në mënyrë të konsiderueshme nga mungesa e fondeve **[M1; M2; M3; M4; M5; M11; M12; M13] [Kapitulli III Standardi I.5]**

1.7 Të gjithë anëtarët e stafit akademik kanë mundësi të marrin pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor. **[M11]** Raportime të ndryshme, siç janë ato nga drejtuesit e departamenteve, dërgohen përmes zinxhirit të hallkave drejtuese deri tek Rektori, i cili më pas përgatit një raport përfundimtar të përgjithshëm të Universitetit dhe ia paraqet atë Senatit Akademik për miratim përpara se të dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe të botohet në faqen online të UA. **[RVV fq.11-12; 1.1 Nenet 9.2.h, 18.2.b, 116.6; M2; M11]** Përbërësit e raportit diskutohen gjerësisht në të gjithë UA-në, për shembull, në Këshillat e Fakultetit. **[RVV fq.11; 1.1 Neni 31.1.d]** Mungesa e një versioni në gjuhën angleze të Raportit Vjetor, përtej pesë faqeve të para, pengoi grupin lidhur me vlerësimin e efektshmërisë së mundshme të tij. Raporti Vjetor përmban Misionin dhe Objektivat e UA-së, ndjekur nga një përshkrim i veprimtarive mësimore, akademike dhe shkencore për vitin. Edhe pse nuk është përkthyer, është e qartë se veprimtaria dhe prodhimi artistik i UA-së janë të gjera. Plani duket se përfundon me të dhënat e arritjeve të studentëve të ndarë sipas departamenteve. **[B.5; C.3] [Kapitulli III Standardi I.6]**

1.8 UA ka struktura të përshtatshme për të përmbushur misionin dhe qëllimin e vet. **[1.0 Neni 3]** UA kryen veprimtarinë e vet në përputhje me parimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike, siç shprehet në statutin dhe rregulloret e veta. UA përbëhet nga tre

fakultete dhe nëntë departamente. **[1.1 Neni 6]** Fakulteti është njësi kryesore, **[1.1 Nenet 4 dhe 5]** departamenti është njësi themelore e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe artistik dhe ka më shumë se shtatë anëtarë efektivë të stafit akademik, të cilët kanë diploma shkencore dhe tituj akademikë. **[RVV fq.13; M11]** UA ofron programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimit në tre fakultete dhe nëntë departamente. **[1.1 Nenet 2 (veçanërisht 2.2), 6; 1.2 Nenet 1, 2; 1.3 Nenet 1, 2]** UA po planifikon të ofrojë një program të ri vitin e ardhshëm, një Master të Shkencave në Mësimdhënie Arti, **[RVV fq. 1.1 Nenet 57, 58, 61, 65, 67, 72, 74]** dhe të zhvillojë një cikël të tretë të programeve të studimit, për të cilat ka dispozita në Statutin e tij. **[RVV fq.11, fq.37. p ., 67; 1.1 Neni 75; M3]** Grupit të vlerësimit iu kumtua që UA kishte marrë akreditim kohët e fundit për të ofruar studime të ciklit të tretë. UA ka faqen e vet zyrtare. **[www.ua.edu.al; kontrolluar 04/04/17] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.9 Edhe pse UA nuk zhvillon në mënyrë sistematike studim të tregut për të përmbushur misionin dhe qëllimin e vet, ai është plotësisht i angazhuar dhe ka njohje aktuale për zhvillimet rajonale dhe kombëtare të artit për shkak të lidhjeve të tij të ngushta me tregun e arteve përmes stafit të tij akademik, alumni, bashkëpunimit të gjerë me organizatat artistike dhe punën e tij direkte në të gjithë botën artistike (shih pikat 1.11 deri 1.14). Për shkak të njohurive të tij për botën e artit dhe mbështetjes në kontaktet e ngushta personale në baza të rregullta, UA nuk ka mbledhur sistematikisht në të kaluarën, një informacion të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin ekonomik rajonal. Ndonëse në nivel departamentesh dhe fakultetesh ka informacion për punësim, UA tani pranon se ka nevojë për një mekanizëm më formal për mbledhjen dhe ruajtjen e informacionit mbi punësimin e të diplomuarve. Institucioni ka filluar të zhvillojë një sistem në mediat sociale për të bërë pikërisht këtë (shih pikën 5.11). **[RVV fq. 14; M3; M4; C.4; <https://www.linkedin.com/edu/akademia-e-arteve-trian%C3%AB-10006>]** UA gjithashtu pranon se jo të gjithë të diplomuarit e vet do të kenë sukses si artistë të nivelit të lartë dhe prandaj është duke zgjeruar mundësitë e punësimit të studentëve përmes nismave të reja të programeve, të tilla si hapja e një Programi të ri Bachelor në Edukimin Muzikor dhe propozimi i ri për Programin Bachelor, Mësues në Arte. **[RVV fq.14] [Kapitulli III Standardi III.1]**

1.10 UA konsideron bashkëpunimin, veçanërisht në nivel ndërkombëtar, një pjesë thelbësore e veprimtarisë së vet, **[RVV fq. 14; 1.4 Kapitulli 6, fq. 17-21]** megjithëse pranon gjithashtu se ka pengesa të konsiderueshme financiare për realizimin e kësaj pjese të strategjisë së vet. **[1.4 Kapitulli 6, fq.22-23]** Gjatë gjithë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dëgjoi për një gamë të gjerë bashkëpunimi rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Shumë nga këto filluan përmes kontakteve personale të artistëve të shumtë të UA-së të njohur ndërkombëtarisht. Disa nga bashkëpunimet ndërkombëtare dhe vendore me bazë në Tiranë gjithashtu sigurojnë mundësi për praktikën profesionale të studentëve. **[1.4 Kapitulli 6, fq.17; 3.39]** Shumë profesionistë arti faktikisht japin mësim me kohë të pjesshme në UA **[M8]** dhe shumica e më shumë se 80 projekteve ku UA u angazhua këtë vit ishin me ose nga ish-studentët e tij. **[M8]** Më poshtë janë disa nga bashkëpunimet e shumta të UA. **[Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4]**

1.11 Në nivel vendor, UA rekruton shumë nga studentët e saj nga Liceu i Tiranës, një shkollë e mesme artistike kryesore në qytet. **[M2]** Gjithashtu ai bashkëpunon me Aleancën Franceze, Institutin Italian të Kulturës, Institutin Goethe dhe Këshillin Britanik. **[M3]** Një anëtar i stafit muzikor bashkërendon serinë e koncerteve sezonale në Tiranë. **[M13]** Një partner interesant është Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila organizoi një konkurs për studentët në vitin 2010 në një projekt për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në familje. Ata ishin të kënaqur me punën e studentëve që fituan konkursin dhe synojnë të përsërisin trajnimin në të ardhmen e afërt, dhe projekti i radhës do të trajtojë të shkuarën dhe ekstremizmin e dhunshëm. Vlen të përmendet fakti që kjo organizatë po rikthehet në UA, nëse merret në konsideratë natyra politike dhe përgjegjshmëria e

organizatës. [M8] Një financues vendor i filmave të animuar dhe të shkurtër integron disa nga veprat e tij në projekte studentore. [M6] Një qendër krijuese për stilistët e modës dhe aksesoreve, për të cilën studentët krijuan një markë të re, do të hapet më pas këtë muaj dhe do të vijojë funksionojë për studentët e vitit të ardhshëm për projekte të tjera. [M8] Një prodhues bizhuterish arti në Tiranë ka punësuar studentët e UA që kur filloi veprimtarinë, sepse sipas tij, ata janë të vetmit që kuptojnë dizajnin grafik me detaje të hollësishme të produktit nga momenti i parë kur fillojnë punën. [M8] [**Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4**]

1.12 Në nivel kombëtar, një klasë e operës performon të paktën katër herë në vit në mbarë Shqipërinë. [M3] Një shkollë kryesuese e koreografisë ofroi mundësi për kryerjen e praktikës profesionale dhe punësoi disa nga studentët që morën pjesë. [M8] Të gjithë këngëtarët në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit të Shqipërisë vijnë nga UA dhe drejtori i saj i përgjithshëm përmend se një i diplomuar i kohëve të fundit, i cili fitoi një çmim të rëndësishëm, tani këndon në Operan La Scala në Milano. [M8] Studentët gjithashtu trajnohen rregullisht dhe këndojnë në teatrin e operës kombëtare, për të cilën marrin kredite për programin e tyre të studimit. [M11] Radio dhe televizioni shqiptar kanë nënshkruar marrëveshje me UA-në dhe punësojnë të diplomuarit e tij si drejtorë, folës dhe gazetarë kulturorë. [M8] Teatri eksperimental në Tiranë punëson studentë dhe pedagogë, ndërsa stafi drejton produksione në Teatrin Kombëtar. [M8; M12] Artistët ekspozojnë në galerinë e arteve të UA, të cilën stafi i UA e konsideron galerinë më të mirë në vend. [M12] [**Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4**]

1.13 Në nivel ndërkombëtar, shumë punonjës performojnë dhe prezantojnë punën e tyre në festivale në SHBA dhe Evropë, përfshirë Festivalin e Filmit Giffoni në Itali dhe Shkollën e Filmit në Pragë. [M3; M4] Studentët performojnë opera në teatrot e Kosovës, Malit të Zi dhe Italisë. [M3] Projektet Erasmus zhvillohen me partnerë në Norvegji, Itali, Gjermani dhe Spanjë [M3; M4; M5; M14] Alumnit aktualisht punojnë në mbarë Evropën. [M3] Ekziston një projekt me Universitetin Loyola në Nju Orleans mbi temën e riciklimit dhe studentët amerikanë vijnë në Tiranë. [M3] Studentët e UA-së shkojnë në Institutin e Arteve Siena. [M4] Klasa mësimore model me figura ndërkombëtare, të tilla si artisti italian Marco Veronese i cili ishte në institucion një javë përpara vlerësimit, janë një karakteristikë e mësimdhënies [M13; M5] UA mirëpret një numër të madh lektorësh të ftuar nga institucionet ndërkombëtare dhe i trajton ata sipas statutit të tij. [1.1 Neni 97; M11] Studentët kanë interpretuar me orkestrat e shkollave në Kosovë dhe Mal të Zi, [M6] kanë vallëzuar në Turqi [M6] dhe kanë aktruar në një produksion të teatrit zvicëran në Gjenevë [M6] Regjisorët e filmave të huaj janë të kënaqur me aktorët nga UA [M8]. Artistët e stafit ekspozojnë veprat e tyre në galeri në mbarë botën, përfshirë në Nju Jork dhe në Paris. [M12] UA gjithashtu punon me Konservatorin e Udines, Konservatorin e Parisit dhe Universitetin e Arteve, Vjenë për të realizuar projekte të ndryshme. [1.4 Kapitulli 6, fq.17; 3.39] [**Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4**]

1.14 UA punon me një numër partnerësh për të ndihmuar në hartimin e programit mësimor. Studentët e arkitekturës dhe tekstit të modës studiojnë në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës një herë në javë. [M6] Stafi dhe studentët përdorin rregullisht hapësirën e performimit në Teatrin Kombëtar për dramën [M13] dhe shtypshkronjat në Tiranë për artet grafike. [M13] [**Kapitulli III Standardi III.3**]

1.15 Marrëveshjet dhe bashkëpunimet e gjera që nxisin ekselencën artistike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare janë një karakteristikë e praktikës së mirë. [**Kapitulli III Standardi III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4**]

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- bashkëpunimet dhe marrëveshjet e gjera që promovojnë ekselencën artistike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare (pika 1.15, Kapitulli III Standardi III.3, Kapitulli III Standardi III.4)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi çdo veprim që është në proces.

Gjykim

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 UA ka staf akademik të integruar dhe staf mësimor ndihmës, staf shkencor dhe personel administrativ. **[M4]** Ai realizon një proces të hapur, konkurrues dhe objektiv për të gjitha emërimet. Për të përmbushur nevojat e mësimdhënies për UA, drejtuesit e departamenteve dhe dekanët e fakultetit hartojnë kërkesën për stafin shtesë që përcillet, përmes këshillave të fakulteteve për miratim në Senatin Akademik. Kriteret e hartuara për çdo post janë në përputhje me legjislacionin, Statutin dhe rregulloret e UA-së, si dhe kërkesat e departamenteve **[1.12; 2.1.1; 2.1.2; 1.1 Nenet 97, 98, 99, 100]** UA publikon kriteret e punësimit për çdo pozicion të lirë pune nga secili fakultet **[1.1 Nenet 99, 100; 1.14; 1.15]** Rektori e plotëson kontratën me kandidatin e suksesshëm në përputhje me ligjin në fuqi, 'Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë' dhe Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. **[RVV fq.18; 2.1.1; 2.1.2; 2.1.3;]** UA mban një ekuilibër të stafit akademik me kohë të plotë dhe stafit me kohë të pjesshme dhe stafit akademik të ftuar ose të kontraktuar, duke i dhënë prioritet ciklit të dytë të studimeve ku është në fokus veprimtaria kërkimore. UA ka përgjegjësinë të punësojë profesorë për të siguruar kualifikimin dhe mbështetjen profesionale më të mirë të mundshme për studentët e tij. Ai ndjek një politikë të integritit të kategorive të ndryshme të stafit, që përfshin realizimin e takimeve në të gjithë institucionin për grupe të ndryshme interesi. **[M1; M2] [Kapitulli III Standardi IV.1; Kapitulli III Standardi IV.2]**

2.2 UA i përmbahet një plani formimi sipas strategjisë së vet të zhvillimit, nëpërmjet arritjes së kualifikimeve dhe specializimeve brenda dhe jashtë vendit. Performanca e punës vlerësohet siç përcaktohet nga Senati Akademik, duke përdorur informacion nga pyetësorët e studentëve, rezultatet e provimeve dhe vlerësimet vjetore. **[4.10.2; 4.10.3; M4]** UA angazhon profesorë të huaj në komisione dhe panele të promovimit të stafit për titujt akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor". **[4.1.2; 4.1.3]** Lektorët fillojnë praktikën e tyre duke mbuluar seminarët. Ata mësojnë teknikat e mësimdhënies nga Profesori i tyre dhe kolegë të tjerë, si dhe nëpërmjet vëzhgimit të një sërë metodash ndaj lëndës të tyre nga stafi i universiteteve të tjera. Mungesa e formimit të vazhdueshëm dhe efikas me metodat e mësimdhënies për stafin akademik është një **dobësi**. Grupi i vlerësimit **rekomandon** për vëmendjen e menjëhershme që UA duhet të aplikojë, dhe për të zbatuar një plan për përmirësimin fillestar dhe të vazhdueshëm të mësimdhënies. **[M4; M11; M13] [Kapitulli III Standardi IV.1; Kapitulli III Standardi IV.2; Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.3 UA ndjek një politikë shumë të mirë shoqërore për stafin e vet, studentët dhe publikun e gjerë. Organizon aktivitete shoqërore në ditë të ndryshme pushimi dhe ndërmerr nisma të tjera në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe në shërbim të komunitetit. Mbështet dhe zhvillon dialogun shoqëror dhe një jetë qytetare aktive përmes teatrit, operës, koncerteve dhe ekspozitave të tilla si Dita Evropiane, të cilën e festoi me një koncert të veçantë. Ekzaminime të hapura bëhen edhe në raste të veçanta për publikun dhe studentët që punojnë me shkollat e mesme. **[M5; M6]** Orkestra e UA-së ka performuar në spitalin amerikan dhe individë nga stafi kanë kënduar himnin kombëtar në ndeshjet sportive (shih gjithashtu pikat 1.11 deri 1.15). **[M5, M6; M8]** Fakti që i gjithë stafi akademik dhe stafi mbështetës janë të përfshirë në veprimtarinë artistike jashtë UA, që kontribuon në jetën shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë, është një karakteristikë e **praktikës së mire**. **[Kapitulli III Standardi IV.2, Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.4 UA përdor kontratat individuale të punësimit që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit. Ai gjithashtu zbaton rregulla të qarta për caktimin e përgjegjësive nën funksionet përkatëse në pajtim me Statutin e vet dhe rregulloret për njësitë bazë të tij. **[C.5 T; 4.1.1; 4.1.4; 4.1.5; 4.1.6; 4.1.7; 4.1.8; 4.1.9; M1] [Kapitulli III Standardi II.2]**

2.5 UA financohet nga transfertat në formën e granteve nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga burime të tjera. **[1.1 Neni 121, 1.a]** Hartimi i buxhetit kryhet në përputhje me Standardet e përcaktuara nga Ministria e Financave. **[1.1 Neni 121.2]** Projektbuxheti bazohet në propozimet e departamenteve, fakulteteve dhe Rektoratit dhe, pas diskutimit, miratohet nga Senati Akademik. Më pas ai kalon në Këshillin e Administrimit, nga ku, pas miratimit, i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (shih gjithashtu pikan 1.2 më lart). **[1.1 Neni 121.1-3; 2.5.1] [Kapitulli III Standardi VI.1]**

2.6 Struktura e menaxhimit financiar të UA është në faqen e tij zyrtare dhe në organogramën e shpallur. UA ndjek një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare. Kjo realizohet përmes raportit analitik të dorëzuar në Senatin Akademik dhe Këshillin e Administrimit për diskutim dhe miratim, si dhe kryerjen e të gjitha transaksioneve financiare vetëm përmes sistemit të thesarit. **[1.1 Neni 118.3; Anketimi i stafit: M1, M3, M4; M11]** Burimet financiare përdoren sipas rregullave dhe standardeve të një organizate publike të arsimit të lartë. UA zbaton rregullat e kontabilitetit të cilat janë të njëjta me ato për institucionet e tjera publike, bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për administrimin e aseteve në njësitë e sektorit publik ". **[1.1 Neni 121.4]** UA ka analizuar monitorimin e politikës së vet financiare, që pasqyron treguesit e tij ekonomikë. **[RVV fq.22; 2.6.1; 2.5.1] [Kapitulli III Standardi VI.2]**

2.7 UA i nënshtrohet auditimit të jashtëm financiar nga struktura administrative e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[1.1 Neni 122.1; 2.7.1]** Raporti i auditimit financiar diskutohet në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, publikohet në faqen e internetit të UA-së dhe gjithashtu bëhet publik për studentët në një kënd të brendshëm informacioni. **[1.1 Neni 122.4] [Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.8 UA ka një sistem të përshtatshëm të menaxhimit dhe administrimit të informacionit elektronik. Ai grumbullon, analizon dhe përdor informacionin përkatës për menaxhimin efikas të jetës akademike dhe veprimtarive që lidhen me të. Ky proces kryhet në përputhje me kërkesat e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. **[RVV fq.23; M2; M5; M6]** Rrjeti Akademik Shqiptar, në bashkëpunim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit të UA-së, ka zbatuar ESSE3, një sistem për menaxhimin e programeve të studimeve dhe kurrikulave. Sistemi është testuar për mbrojtje kundër dështimit dhe ngjarjeve katastrofike. **[RVV fq. 22]** Digjitalizimi i kurrikulës dhe administratës ka filluar në vitin akademik 2013-2014. Proceset që mund të administrohen në mënyrë elektronike përfshijnë administrimin e dokumentacionit të studentëve, provimeve dhe tarifave. Të gjithë studentët kanë akses individual në sistem dhe një llogari email. **[RVV fq.22; M2, M5, M6] [Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.9 Biblioteka ka dy sisteme informacioni, një sistem të integruar të administrimit të pronave fizike dhe katalog online dhe arkivin digjital, i cili u krijua përmes një projekti me Bankën Botërore. Secili sistem ofron mbrojtje kundër ngjarjeve katastrofike dhe është kolauduar. Biblioteka gjithashtu zotëron një hapësirë të rrjetit të arkivimit për *backup* të materialeve studimore dhe administrative. Biblioteka ka një server të thjeshtë me materiale audio për të përmbushur nevojat e mësimdhënies dhe të të nxëniet të Fakultetit të Muzikës. Koleksioni i digjitalizuar i bibliotekës është ruajtur në një arkivë të veçantë. Fakulteti i Artit Dramatik zotëron një hapësirë në rrjet ku veprat e filmit katalogohen dhe ruhen në DVD, gjë që është veçanërisht e dobishme për ata që planifikojnë një karrierë në regji televizioni. **[RVV fq. 3-24; 2.12.1; M4, M5, M6, M10; M12]** Biblioteka ruan arkivin e gjerë të UA-së për aktivitetet e veta historike, dhe ambienti i saj me akses të lirë i lejon ato të jenë të disponueshme ndërkombëtarisht. Disponueshmëria e favorshme e një arkivi të gjerë të veprimtarive historike, që u mundëson studentëve të kenë akses në punën e studentëve të mëparshëm, si dhe në filmat dhe muzikën e filmave shqiptarë është një karakteristikë e **praktikës së mirë**. Nëpërmes portalit, studentët dhe lektorët mund të kenë burime

elektronike dhe informacione për ngjarje të ndryshme, si seminare, klasa model, konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, programe shkëmbimi, ekspozita, orë mësimore dhe provime (shih gjithashtu pikan 5.7) **[M2, M5, M6; M10] [Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardet VII.2; Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.10 UA ka pesë servera dhe dy njësi për ruajtjen e materialeve në rrjet. Pajisjet dhe laboratorët kryesorë janë të pajisura me kompjuterë për përdorim nga studentët dhe për qëllime mësimore, siç janë laboratorët e përpunimit të filmit dhe të prodhimit për Fakultetin e Artit Dramatik, dhe një sallë performimi teatri eksperimental (*black-box performance hall*) me një kompjuter në dhomën e kontrollit për sistemin audio dhe projeksion multimedial. Klasat dhe sallat e leksioneve janë të lidhura me rrjetin kompjuterik dhe infrastrukturën elektronike. **[RVV fq.25; Anketimi i studentëve; M2, M5, M6, M10]** Janë krijuar kapacitete për kryerjen e mësimit në distancë, si një sallë e re leksionesh në Fakultetin e Muzikës, i cili ka lidhje me burimet e bibliotekave elektronike, sistemin qendror audio dhe një njësi të dedikuar për video-konferencat, por UA aktualisht nuk ofron mësim në distancë. **[RVV fq.25, Anketimi i studentëve; M2; M5; M6; M10] [Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.11 UA kryen kontroll periodik të aseteve për të përcaktuar përparësitë, dhe mbi këtë bazë, planifikon shërbime dhe investime; universiteti hartoi masterplane në vitin 2011 dhe 2014. Ai ka dëshmi të hollësishme të aseteve të tij, përfshirë një inventar fizik të ndërtesave, projekte fillestare dhe të përditësuara të ndërtesave, një plan për funksionin e çdo ambienti mësimor dhe deklaratat e sipërfaqes për çdo ambient mësimor. Tani ekziston një studim fizibiliteti në lidhje me zgjerimin, ristrukturimin dhe rikonfigurimin e pasurive të paluajshme të UA-së, që i referohet gjithashtu kurrikulave, orarit të mësimdhënies dhe numrit të studentëve krahasuar me orientimin dhe normat e Standardit ndërkombëtar. **[1.1 Neni 123; 2.10.1; 2.12.1; M3] [Kapitulli III Standardi VII.3]**

2.12 UA ndodhet në qendër të Tiranës dhe në ndërtesa që kanë statusin e një monumenti kulturor. **[2.12.1; M10]** UA menaxhon pasuritë e veta për të mbështetur punën e tij me dhomat e praktikës, ambientet e performimit për teatër dhe muzikë, një galeri publike për ekspozita dhe ambiente mësimore të përgjithshme. Hapësirat e praktikës nuk janë të përshtatura mirë për izolimin akustik dhe studentët e modës kanë hapësira të kufizuara. UA e jep me qira sallën e vet të koncerteve dhe punon me organizata të tjera në Shqipëri, si Teatri Kombëtar dhe Teatri Eksperimental për të ndarë hapësirën e performimit. **[1.1 Neni 2; 2.13.1; M3, M4, M5, M6, M10; M13; Anketimi i studentëve] [Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.13 Nga analiza e të gjithë treguesve që ndikojnë në mjedisin e ndërtuar që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mundi të shqyrtojë, UA plotëson kriteret e kërkuara në Standardet . Ka ndërtesa që kanë më shumë se dy dalje që lejojnë evakuimin e menjëhershëm në raste rreziku. Studentët, megjithatë, kanë shqetësime lidhur me zhurmën dhe temperaturës. Aksesit për personat me aftësi të kufizuara është i dobët. **[Anketimi i studentëve, 2.14.1; 2.14.2; M5; M6] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.14 Veprimtaria akademike përpunohet rregullisht në mënyrë elektronike. Sekretaritet mësimore hartojnë dhe ruajnë katalogimin dhe arkivin kryesor për çdo fakultet, i cili ekziston në kopje fizike dhe elektronike. Këto ruhen lokalisht dhe në një server qendror dhe janë kolauduar për mbrojtje nga ngjarjet katastrofike. **[RVV fq.24; 2.15.2; M2, M5] [Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktikë e mire

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- gjithë stafi akademik dhe mbështetës janë të përfshirë në veprimtarinë artistike jashtë UA, që kontribuon në jetën shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë (pika 2.3; **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- disponueshmëria e favorshme e një arkivi të gjerë të veprimtarive historike që u mundëson studentëve të kenë akses në punën e studentëve të mëparshëm, si dhe në filmat dhe muzikën e filmave shqiptarë (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi VII.4**)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një trajnimi të vazhdueshëm dhe efektiv në metodat e mësimdhënies për stafin akademik (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.3**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të krijojë dhe zbatojë një plan për përmirësimin imediat dhe të vazhdueshëm të mësimdhënies (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.3**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka bërë ndonjë pohim.

Gjykim

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 UA ka zhvilluar programet e tij të studimit dhe kurrikulën në përputhje me Planin e vet Strategjik 2014-19. Ky dokument përcakton vizionin e UA-së për t'u zhvilluar si një qendër që kombinon kërkimet akademike me nivelin më të lartë të përgatitjes dhe kualifikimit në praktikën e arteve krijuese. Ai gjithashtu përcakton mënyrat në të cilat UA kërkon të mbajë formatin e programeve të tij dhe rëndësinë e tyre në nevojën për të siguruar punësueshmërinë e të diplomuarve. **[1.4]** Programet e studimit të UA-së janë zhvilluar në përputhje me Planin Strategjik. Ai ofron 32 programe në nivelin Bachelor (cikli i parë) dhe 32 programe në nivelin Master (cikli i dytë), përfshirë Master Profesional (që kërkojnë 60 kredite ECTS) dhe Master i Arteve të Bukura dhe Master i Shkencave (që kërkojnë 120 Kredite ECTS). **[3.1]** Aktualisht, nuk ka programe të ciklit të tretë, edhe pse UA ka aplikuar dhe marrë lejen e nevojshme për t'i hapur këto programe. **[1.4; M1]** Grupit të Vlerësimit të Jashtëm i la mbresë aftësia e stafit dhe studentëve në të gjitha nivelet për të artikuluar një vizion të qartë për UA-në dhe për ta përkthyer këtë në një mjedis mbështetës në të cilin studentët janë në gjendje të zhvillojnë talentet e tyre individuale dhe stafi akademik është në gjendje të prodhojë punë krijuese. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron fokusin në vizionin e UA që ndahet midis stafit dhe studentëve në gjithë universitetin, si një karakteristikë **praktikës së mirë**. **[M1; Anketimi i studentëve] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.2 Programet e UA-s shpallen për studentët e mundshëm përmes faqes së vet të internetit si dhe në mediat sociale. UA mban kontakte me drejtuesit e shkollave dhe ka lidhje të ngushta me shkollat e mesme të orientuara në art, për shembull Liceun e Tiranës. **[RVV fq.36]** Pranimi në programet e ciklit të parë është një proces me dy faza. Të gjithë nxënësit që kanë përfunduar maturën kanë të drejtë të konkurrojnë në testet e përzgjedhjes dhe audicionet e organizuara nga UA. Ka konkurrencë të fortë për vendet në shumë prej programeve, dhe në vendimet për pranime në testet e përzgjedhjes dhe audicionet, i kushtohet vëmendje e veçantë performancës së aplikantëve. Pranimi në programet e ciklit të dytë kërkon një kualifikim të suksesshëm të ciklit të parë dhe sukses në konkurrimet e hapura me bazë audicionet. **[RVV fq.36]** Konkursët në të dy nivelet janë nën autoritetin e Senatit Akademik. **[3.19; 3.20]** Rregulloret për pranimi i nënshtrohen një vlerësimi të rregullt nga departamentet, dhe çdo ndryshim i propozuar miratohet nga Senati Akademik. **[RVV fq.36; B.5 fq.6-7]** Studentët pranohen nga jashtë Shqipërisë, në varësi të një sistemi kuotash. **[RVV, fq.37]** Procedurat për vlerësimin e punës së studentëve janë të përcaktuara qartë në grupin përkatës të rregulloreve të programit të studimit dhe diplomimit. **[1.2; 1.3] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.3 Aktualisht, UA ofron vetëm programe studimi me kohë të plotë dhe nuk ka ndërmend të prezantojë programe studimi me kohë të pjeshme. **[RVV fq.37]** Plani Strategjik i UA-së deklaron orientimin për promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Universiteti e përmbush këtë përmes organizimit të shkollave verore dhe programeve të tjera që i drejtohen, për shembull, mësuesve të shkollave. **[1.4 fq.3; M4] [Kapitulli I Standardi I.2]**

3.4 Programet e studimit në të dy ciklet hartohen nga departamentet dhe miratohen nga Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit. Rregulloret përcaktojnë qartë se çfarë duhet të përfshihet në një propozim për një program të ri. **[1.2; 1.3]** Fokusi i programeve të ciklit të parë është kualifikimi bazë artistik dhe profesional. Programet e ciklit të dytë synojnë të rrisin nivelet artistike dhe gjithashtu të përfshijnë kualifikim në arsim. **[RVV, fq.38]** Përfundimi i një programi të ciklit të dytë kërkon paraqitjen e një teze diplome që përmban rreth 22 për qind të krediteve të kërkuara. Puna për tezën e diplomës mund të realizohet në institucionet partnere diku tjetër në Shqipëri ose jashtë saj. **[RVV fq.43] [Kapitulli I Standardi I.3]**

3.5 Programet e studimit konfirmohen çdo vit nga Senati Akademik, i cili ka në përbërje edhe përfaqësuesit e studentëve. Kur një departament ose fakultet dëshiron të propozojë ndryshime në kurrikula, ai mund ta bëjë këtë. **[1.2; 1.3; C.7]** Gjuhët e huaja, veçanërisht

anglishtja dhe frëngjishtja, janë pjesë përbërëse e kurrikulës së të gjitha programeve të studimit në UA. **[Kapitulli I Standardi I.4]**

3.6 Pedagogët në UA nënshkruajnë marrëveshje individuale çdo vit që përcaktojnë në mënyrë të detajuar detyrimet e tyre të mësimdhënies. **[3.28; 3.29]** Marrëveshjet gjithashtu mbulojnë veprimtarinë shkencore dhe artistike ku pedagogu pritet të angazhohet. **[RVV fq.40]** Pjesa më e madhe e mësimdhënies kryhet nga personeli me kohë të plotë, por çdo program studimi gjithashtu përdor në mënyrë të konsiderueshme pedagogë të jashtëm me aftësi të specializuara. Në të dy nivelet, ciklin e parë dhe të dytë, gati 30 për qind e mësimdhënies ofrohet nga pedagogë të tillë me kohë të pjesshme. Për arsye financiare, UA nuk është në gjendje të paguajë kompensimin shtesë të personelit për orë të realizuara përtej atyre të rëna dakord, edhe pse në praktikë, pedagogët me kohë të plotë e tejkalojnë rregullisht dhe konsiderueshëm ngarkesën e orëve të rëna dakord. **[RVV, fq.39-40]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se metodat intensive të mësimdhënies në UA kushtojnë të paktën gjatë herë më shumë për student, krahasuar me koston mesatare në universitetet e tjera shqiptare. **[M1]** Pamundësia për të paguar në kohë lektorët me kohë të pjesshme gjatë kohëve të fundit, gjë që ka çuar në vështirësi të mëdha në organizimin e programeve të studimit, është një **dobësi [B.4 fq.5]** Grupi i vlerësimit **rekomandon** për vëmendje të menjëhershme, që UA duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që të mund të paguajë të gjithë stafin në përputhje me detyrimet kontraktuale **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.7 Informacioni për studentët e regjistruar në programet e studimit të UA ofrohet përmes materialit të shtypur. **[3.4; 3.7; 3.8]** Informacioni është gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të UA, dhe studentët komentuan se ata e përdorin atë. **[<http://www.UA.edu.al>; M5]** Gjatë kohës që studenti është në UA, ai ose ajo pritet të mbetet në kontakt me stafin administrativ dhe gjithashtu të përdorë llogarinë e tij / saj personale në sistemin e informacionit të UA-së, me qëllim marrjen e informacionit të mëtejshëm. **[M2]** Përmbledhjet e kurrikulës për secilin program janë të skicuara pa zhvillim detajesh, por planet mësimore për secilin kurs përcaktojnë qartë rezultatet e pritshme të të nxënit, regjimin e vlerësimit, përshkruarit e notave dhe organizimin e kursit. Për shumicën e programeve mësimore përdoret një formë Standardie, por kjo nuk përdoret për të gjitha programet mësimore. **[3.7; 3.8]** Studentëve që përfundojnë kurset e tyre të studimit, u jepet një diplomë formale. Një suplement diplome në gjuhën shqipe dhe angleze përcakton në detaje programin e studimit që kanë ndjekur, duke përfshirë objektivat e kursit dhe notat e fituara. **[3.23.1; 3.23.2]** **[Kapitulli I Standardi I.6]**

3.8 Programet e ciklit të parë në UA zgjasin tre vjet dhe kanë 180 kredit ECTS. Fokusi i të gjitha programeve, në përputhje me misionin e institucionit, është arritja e Standardeve më të larta të performancës dhe praktikës artistike. Në të njëjtën kohë, kurrikula lejon hapësirë për studimin e anglishtes dhe kurseve të tjera kontekstuale. **[3.7]** Natyra e programeve të ofruara në UA bën transferimin nga institucionet e tjera të pa realizueshme, ndonëse transferimi brenda institucionit është i mundur. **[RVV fq.41-2]** Përfundimi i një kualifikimi të ciklit të parë është hartuar për të krijuar mundësi punësimi, por aktet rregullatore aktuale shtetërore nënkuptojnë që të diplomuarit nga UA nuk janë në gjendje të konkurrojnë për pozicione mësuesie në sistemin arsimor shqiptar. **[RVV fq.42]** **[Kapitulli I Standardi I.7]**

3.9 Studentët në UA pritet të punojnë ngushtë me pedagogët e tyre individualë dhe mësimdhënësi kryesor në fushën e studimit të studentëve pritet të marrë përgjegjësinë për drejtimin dhe këshillimin e studentëve. **[RVV fq.42]** Personeli administrativ pritet gjithashtu të luajë një rol të rëndësishëm në orientimin e studentëve dhe informimin e tyre për kërkesat e programit. **[5.5]** Studentët kanë llogari personale në portalin e studentëve të UA-së dhe pritet të kenë informacion në lidhje me programet e tyre të studimit përmes këtyre mjeteve. **[RVV fq.42; M5; M6]** Metodat e mësimdhënies mbështeten shumë në kontaktin personal midis studentëve dhe pedagogut, veçanërisht në fushat artistike dhe të performimit. **[M5 M6]** 73

për qind e mësimdhënies kryhet nga personeli me kohë të plotë, dhe pjesa tjetër mbulohet nga lektorët e ftuar me aftësi dhe përvojë të specializuar. **[RVV fq.42] [Kapitulli I Standardi I.8]**

3.10 Programet e ciklit të dytë të UA-së janë të orientuara drejt zhvillimit të mëtejshëm të performancës së studentëve dhe aftësive artistike. **[1.3 Neni 5]** Përfundimi i një projekti të diplomës, i ndërmarrë në disa raste në një institucion partner jashtë UA-së, është një pjesë e rëndësishme e programit, por kriteret për projektin fokusohen në dimensionin artistik po aq sa edhe në dimensionin kërkimor. **[1.3 Nenet 30-33]** Raporti i vetëvlerësimit i UA-së i referohet rëndësisë së rekrutimit të stafit të angazhuar në kërkim shkencor dhe gjithashtu i referohet "veprimtarive kërkimore/artistike". Në të njëjtën kohë, raporti pranon se fokusi i tij është në performimin dhe prodhimin artistik dhe jo në kërkim shkencor në kuptimin tradicional të termit. **[RVV fq.53] [Kapitulli I Standardi I.9]**

3.11 UA ka organizuar programet e veta në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe thekson se jepet mësim përgjatë linjave të ngjashme në institucionet homologe kudo në Evropë. Kurrikula dhe programet mësimore japin informacion të plotë në gjuhën angleze dhe shqiptare rreth punës që studentët kanë përfunduar në UA. **[3.7; 3.8]** Studentët duhet të mësojnë dy gjuhë të huaja, normalisht anglisht dhe frëngjisht, edhe pse vetëm një vëllim i kufizuar kreditesh është caktuar për këto dije. Vlerësimi i gjuhës bëhet nga agjencitë e jashtme, të cilat janë të licencuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për të siguruar cilësinë. **[RVV fq.44]** UA ka një sërë marrëveshesh me universitetet dhe akademitë muzikore në pjesë të tjera të Evropës, disa prej të cilave financohen përmes Erasmus +. Veprimtaritë e parashikuara përfshijnë shkëmbimet e studentëve, edhe pse ende nuk ka programe të përbashkëta. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ishte i qartë nga dëshmitë nëse këto marrëveshje janë plotësisht funksionale dhe ofrojnë mundësi të mëdha për studentët e UA-së që të angazhohen me kolegët e tyre ndërkombëtarisht. Studentët kanë rregullisht alternativa për të kryer studimet jashtë vendit, dhe studentët me të cilët u takua grupi i vlerësimit, ishin shumë mirënjohës për këto mundësi. **[1.23; M3; M5; M6]** Ata gjithashtu përfitojnë nga klasat model mbajtur nga artistë dhe artistë të mirënjohur. **[M5]** Zbatohen politika për të lejuar transferimin e krediteve nga një institucion i huaj. **[3.32] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.12 Kurset që ofrohen në UA janë hartuar në mënyrë që aspektet praktike të zënë vendin e parë. Institucionet krijojnë mundësi të ndryshme për studentët për të treguar arritjet e tyre praktike, për shembull koncerte, shfaqje dhe ekspozita. Përcaktimi i krediteve bazohet kryesisht në kohën e kaluar për veprimtarinë praktike. **[RVV fq.45; 3.7; M1]** Projektet e diplomave që kërkohen për të gjitha programet e studimit ofrojnë mundësi shtesë për studentin të tregojë aftësitë dhe kompetencat e tij profesionale artistike për të kryer punën praktike **[1.3 Neni 30]**. Mundësitë për praktikën e hershme skenike që u mundësojnë studentëve të fitojnë përvojën e performancës në një mjedis profesional, janë një karakteristikë e **praktikës së mirë.****[1.3 Nenet 30-33] [Kapitulli I Standardi I.11]**

3.13 UA konsideron se të diplomuarit e tij kanë mundësi të kërkojnë punësim në nivel ndërkombëtar dhe vendor, dhe harton kurrikulën e tij në mënyrë që të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare. **[RVV fq.46]** Ai ka pritshmëri për shfaqje dhe ekspozita nga studentët në të gjitha fazat, pjesërisht për t'i bërë talentet e studentëve të njohur dhe për t'i dhënë më shumë mundësi punësimi në të ardhmen. Bashkëpunimi me partnerët e jashtëm për lloje të ndryshme projektesh, për shembull filmi i shkurtër dhe prodhimi i filmave të animuar, u japin studentëve përvojë praktike. Përfaqësues nga disa organizata të mëdha, përfshirë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, folën me vlerësim të lartë për cilësinë e të diplomuarve të UA-së. **[M8]** Programet e ciklit të dytë gjithashtu përfshijnë kualifikime specifike në pedagogji, megjithëse aktet rregullatore aktuale të qeverisë e bëjnë të vështirë në praktikë që të diplomuarit e UA të punojnë si mësues në shkollat fillore dhe të mesme. Vetëm katër kredite ECTS janë përcaktuar për këtë veprimtari. Programet e ciklit të parë janë gjithashtu të ngushtë në fokus, me vetëm një modul për menaxhim projektesh dhe

një modul për shkrim akademik. **[RVV fq.42; 3.7]** Përveç këtyre veprimtarive, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ishte në gjendje të gjejë ndonjë dëshmi për përgatitje të ndryshme për karriera të tjera që nuk bazohen në përgatitjen për një karrierë profesionale në krijimin e produkteve artistike, siç është performimi, edhe pse studentët në dyja ciklet, kur u pyetën në mënyrë specifike rreth punësueshmërisë në takimet e tyre përkatëse, ranë dakord se jo të gjithë ata mund të shprejonin të gjejnë punë si artistë profesionistë. **[M5; M6]** Fakti që nuk ka kualifikim të rëndësishëm për një karrierë të ndryshme nga ajo e një artisti profesionist, është një **dobësi**. Grupi i vlerësimit **rekomandon** për vëmendje të menjëhershme, që UA të rishikojë kurrikulën e vet për të ofruar më shumë aftësi të transferueshme karriere. UA sapo ka filluar të mbledhë sistematikisht të dhënat e punësimit për të diplomuarit e vet. Megjithatë, ai ka nisur një projekt novator për të gjurmuar alumni përmes mediave sociale (shih pikan 5.11). **[M3, M4] [Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Fokusi në vizionin e UA që bashkë ndahet nga stafi dhe studentët në universitet (pika 3.1, Kapitulli I Standardi I.1)
- Mundësitë për praktikë në faze të hershme në skenë, që u mundësojnë studentëve të fitojnë përvojën e performancës në një mjedis profesional (pika 3.12; Kapitulli I Standardi I.11)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- pamundësia për të paguar lektorë me kohë të pjeshme në kohën e duhur në kohët e fundit, që ka çuar në vështirësi të mëdha në organizimin e programeve të studimit (pika 3.6, Kapitulli I Standardi I.5)
- Nuk ka kualifikim të rëndësishëm për një karrierë ndryshe nga ajo e artistit profesionist (pika 3.13; Kapitulli I Standardi I.12).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që ai të mund të paguajë të gjithë stafin në përputhje me detyrimet kontraktuale (pika 3.6, Kapitulli I Standardi I.5)
- Për vëmendje të menjëhershme, UA duhet të rishikojë plan programin e vet për të ofruar më shumë aftësi të transferueshme karriere (pika 3.13; Kapitulli I Standardi I.12).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka konfirmuar ndonjë veprim që është në progres.

Gjykim

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Programet e studimit në UA janë organizuar në mënyrë efikase. Ato miratohen dhe shqyrtohen rregullisht nga strukturat qeverisëse të UA-së çdo vit. Këto procese kryhen në përputhje me rregulloret e UA-së. **[1.1; 1.2; 1.3]** Departamentet akademike janë përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e programeve të studimit. Stafi akademik i UA mban tituj akademik dhe grada shkencore të dhëna nga shteti shqiptar. Ashtu si me shumë institucione të artit në mbarë botën, ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm të punonjësve me kohë të pjesshme të cilët ushtrojnë profesionin. **[4.1.1; 4.1.6; 3.25; 3.28; M13]**

4.2 UA është përgjegjës për kualifikimin praktik të studentëve dhe për formimin e zhvillimin profesional dhe artistik të tyre. Për këtë nevojiten shumë orë pune praktike në mjedise të ndryshme në institucion. Departamentet dhe stafi akademik drejtojnë dhe mbikëqyrin procesin e përgatitjes së diplomës. UA ka burimet e duhura të bibliotekës për të mbështetur nevojat e studentëve. Biblioteka ka dhe burime të tjera në dispozicion online për të gjithë studentët dhe lektorët **[4.5.5; 4.6.2; 4.6.3; 5.15; 5.16; 5.17; M4]** **[Kapitulli I Standardi II.1]**

4.3 Rregulloret e UA-së përcaktojnë qartë të gjitha aspektet e programeve të studimit të studentëve. Këto përfshijnë sistemet dhe metodologjitë e vlerësimit, koordinimin kohor të provimeve, kreditet e studentëve dhe kërkesat formale për avancimin e mëtejshëm. **[1.2; 1.3]** Vlerësimi i njohurive merr forma të ndryshme, duke përfshirë provimet me shkrim dhe me gojë, projektet, provimet e veçanta që përfshijnë vlerësimin e niveleve artistike dhe profesionale të studentëve dhe kombinimet e tyre. Për shkak të karakteristikave të tij të veçanta, UA përdor gjithashtu teste grupore në fusha të caktuara, si në Artin skenik dhe në Fakultetin e Muzikës. Provimet me shkrim ruhen nën kushtet e konfidencialitetit dhe rezultatet nuk janë të disponueshme publikisht. **[1.3; 1.4]** Nëse studentët nuk pajtohen me vlerësimin e tyre, ata mund të apelojnë në Dekanat, që ngre një komision të posaçëm për të dëgjuar rastin. **[4.8.1; 4.8.2; 4.8.3]** Studentët gjithashtu kanë të drejtë të japin një provim përsëri për të përmirësuar notat e tyre, dhe ata mund të bëjnë këtë duke i bërë një kërkesë me shkrim sekretarisë administrative brenda një jave pas provimit fillestar. Informacioni për notat e studentëve ruhet në formë digjitale dhe është konfidencial. **[4.5.2]** **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.4 Programet e studimit dhe nivelet e diplomimit analizohen në fund të çdo viti akademik dhe shqyrtohen nga stafi i fakultetit dhe departamentit. **[3.15]** Vlerësimet e studentëve për programet dhe stafin akademik zhvillohen në fund të vitit. Programet janë modifikuar dhe ato të reja janë hapur në përputhje me një plan vjetor dhe marrin parasysh kontributin e medias, aplikimet në universitet dhe partnerët **[M4; 4.4.4]** Vlerësimi pozitiv i programeve konfirmohet nga pranimi i të diplomuarve të UA në institucionet prestigjioze artistike si Opera e Parisit, mediat italiane dhe Teatri Kombëtar Shqiptar. **[M8; 4.10.3; 4.5.2]** Ka fakte nga mediat sociale se të diplomuarit e UA-së kanë nivele të larta punësimi (shih pikën 5.11), **[M4; M11]**, por një Zyrë për Alumni do të jetë në gjendje të ofrojë ndihmë të mëtejshme për studentët. Kurset tre deri në gjashtë mujore ofrohen për alumni të diplomuar, për t'u mundësuar përditësimin e njohurive të tyre. **[M4; M11]** **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.5 Departamentet akademike kontrollojnë dhe mbikëqyrin cilësinë e programit. Përmirësimi i cilësisë bazohet në nivelin e lartë akademik dhe profesional të stafit akademik. UA ka qenë në gjendje të rekrutojë artistë dhe interpretues të cilësisë më të lartë në vend për të mbështetur veprimtarinë e vet mësimore dhe kërkimore. Për shembull, vetë Rektori është një aktor me reputacion ndërkombëtar dhe një anëtar i shquar i kompanisë Kombëtare të Teatrit; Profesori i violinës gjithashtu ka një karrierë ndërkombëtare dhe ka performuar si solist me orkestra kryesore amerikane; dhe një alumni i diplomuar është një nga këngëtarët

më të respektuar, në mos më i miri, në Shqipëri. **[C1]** Nga 115 punonjës me kohë të plotë, 85 mbajnë titullin e profesorit ose profesorit të asociuar. **[4.1.4]** Ndikimi tek studentët që drejtohen dhe orientohen në mësimdhënie nga profesionistë të tillë, është se ata marrin mësim praktik që përputhet me Standardet më të larta të njohura profesionale. Rekrutimi i artistëve dhe interpretuesve të cilësisë më të lartë në vend për të mbështetur veprimtarinë e mësimdhënies dhe hulumtimit të UA është një karakteristikë e **praktikës së mirë**. **[M3; M8; M11; M12; C1]** Kurrikulat e tij nxisin inovacionin në artin e skenës, të muzikës dhe artet figurative. Rritja e cilësisë së mësimdhënies është nën vëmendjen dhe mbikëqyrjen e drejtuesve të departamenteve dhe lektorëve të lëndëve. Marrëveshja vjetore e nënshkruar nga secili pedagog është një mundësi për të kontrolluar se pritshmëritë e përcaktuara në marrëveshjen për vitin e kaluar janë përmbushur. **[M4] [Kapitulli I Standardi II.4]**

4.6 Kërkimi shkencor në kontekstin specifik të UA-së barazohet me krijimtarinë artistike dhe produkti është i organizuar në nivelin e departamentit. Departamentet organizohen në bazë të grupeve mësimore dhe fushave specifike të artit. Këto grupe përcaktojnë pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pa dëshmi të qarta dhe të dukshme të përparësive të departamenteve, pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Kërkimi konsiderohet kryesisht si një aktivitet individual, i bazuar në talentet artistike dhe aftësitë interpretuese të veçanta, dhe kështu është përparësi arritja individuale e ekselencës artistike. UA gjithashtu mbështet dhe inkurajon krijimtarinë artistike kolektive me projekte dhe aktivitete në shkallë të gjerë, si ekspozita, festivale, konkurse krijuese. **[5.22; 1.23]** UA krijon mundësi për stafin akademik dhe studentët në të gjitha nivelet për të realizuar dhe prezantuar idetë, talentet, projektet dhe krijimtarinë e tyre dhe ofron objekte, salla, staf, instrumente, skena, hapësira dhe infrastrukturë për këto qëllime. UA inkurajon dhe promovon talente të reja dhe krijues të rinj **[1.23; 5.22; M1; M4; M11]** Shfaqjet publike të studentëve si në Tiranë ashtu edhe në nivel ndërkombëtar ofrojnë mundësi për identifikimin e studentëve të shquar. **[M1]** Stafi akademik i UA-së prodhon punë krijuese në nivel ndërkombëtar (shih pikën 1.13) dhe përderisa në kontekstin e veprimtarisë krijuese të arteve, vepra artistike barazohet me kërkimin shkencor, kjo njohje ndikon në ngritjen e profilit të UA në mbarë botën. Ky staf akademik që prodhon punë krijuese në nivel ndërkombëtar është një karakteristikë e **praktikës së mirë**. **[M1; M4; M11] [Kapitulli II Standardi I.1]**

4.7 UA inkurajon pjesëmarrjen në projekte kërkimore dhe artistike. **[5.22; 5.23, 1.23]** Mbështetja për zhvillimin dhe dinamizmin e kërkimit sigurohet nga bashkëpunimi me institucionet kombëtare, të garantuara përmes marrëveshjeve të nënshkruara, si dhe me praninë e stafit të këtyre institucioneve në UA, ku ata japin mësim dhe marrin pjesë në projekte të përbashkëta. **[4.1.9]** Profesorët dhe drejtuesit e lartë në mënyrë të përsëritur deklaruan se UA nuk ka pasur gjithmonë fonde të mjaftueshme për kërkim, **[M1; M3; M4; M12]** por ka përkrahur krijimtarinë artistike dhe një mjedis të favorshëm nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës dhe hapësirës për studentët dhe lektorët e vet. **[M4; M11; M14]** UA është i përfshirë në projekte të financuara nga Komuniteti Evropian nëpërmjet Erasmus + dhe TEMPUS. **[M12; M13; M14] [Kapitulli II Standardi I.2]**

4.8 UA është zhvilluar duke u bazuar në fushat e tij specifike ku mbizotëron, duke u përqendruar në organizimin e pjesëmarrjes në aktivitete artistike, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Kjo punë është kryer nga stafi akademik dhe artistik në bashkëpunim me profesionistë të huaj. **[3.39; 4.42.1; M13; M14]** UA organizon konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, koncerte, ekspozita, klasa model, dhe veprimtari të tjera që lidhen me jetën artistike dhe skenike. Ai gjithashtu lehtëson aplikimet për grante për këto qëllime. UA ruan një prani në media dhe krahasuar me universitetet e tjera organizon më shumë aktivitete dhe ngjarje ndërkombëtare. **[4.10.2; 4.10.3; 3.36; M4; M14]** UA nuk organizon shumë botime, ose konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Mësimi në vetvete është shpesh pjesë e krijimit artistik. UA organizon aktivitete ndërkombëtare, rajonale, kombëtare dhe vendore sipas një kalendari të rregullt, periodik, i cili hartohet çdo sezon. **[5.1; M12; M13; M14]**

4.9 UA dhe bashkëpunëtorët e tij, si Teatri i Operas dhe Baletit dhe Teatri Kombëtar, kanë ndihmuar në ndërkombëtarizimin e artit shqiptar në Ballkan, në Evropë dhe më gjerë. Shumë ngjarje artistike janë organizuar në mbarë botën (shih pikën 1.13). **[3.39; 3.38; provat, pika 3.37-4.1.6] [Kapitulli II Standardi I.3]**

4.10 Kërkimi shkencor në kontekstin specifik të UA-së barazohet me krijimtarinë artistike dhe produkti është i organizuar në nivel departamenti. UA mbështet përparësitë novatore të fakulteteve dhe departamenteve të tij, si dhe të individëve, artistëve dhe profesionistëve në fusha të ndryshme. **[1.11; 1.4]** Këto lidhen me fushat që mbulojnë programet e studimit dhe prodhimin artistik **[M4; M11; M12; M14]** UA inkurajon debatin krijues artistik në fushat e tij të përparësisë. **[B4] [Kapitulli II Standardi I.4]**

4.11 UA fokusohet në disa fusha përparësie të krijimtarisë artistike dhe pedagogjike në përputhje me planin e vet strategjik dhe rekruton personelin mbi këtë bazë. **[1.4, 2.1]** Fushat e përparësisë janë të orientuara drejt kërkesës së tregut dhe zhvillimeve në shoqërinë shqiptare, dhe kjo ka çuar në përfshirjen e fushave të tilla si xhazi dhe muzika popullore. **[RVV fq.54; 1.26]** Janë inkurajuar idetë e reja dhe novatore nga stafi akademik. Siç përmendet në pikën 4.7, UA inkurajon bashkëpunimin me pjesëmarrje në projektet dhe konkurset ndërkombëtare si një mjet për të rritur aktivitetin e vet krijues. **[1.23] [Kapitulli II Standardi I.5]**

4.12 Raporti i Vetëvlerësimit të UA-së nuk ka trajtuar **Kapitullin II Standardin I.6, Kapitullin II Standardin I.7 dhe Kapitullin II Standardin I.8.** Bazuar në provat e mbledhura gjatë vizitës dhe nga baza e provave, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është në gjendje të komentojë se UA ka krijuar një pozicion unik për veten e vet në Shqipëri si një institucion që përqendrohet kryesisht në arritjen e niveleve të larta të krijimit artistik dhe aktivitetit në përputhje me kapacitetin e tij. **[M1]** Në këto aspekte bashkëpunon ngushtë me organet artistike kombëtare si Teatri Kombëtar. **[3.39; 4.12.1; M3]** Studentët dhe stafi më i ri mentorohen nga afër nga më të vjetrit dhe kështu janë në gjendje të jenë pjesë e veprimtarive të grupit, si dhe që të krijojnë karriera individuale. Në mënyrë aktive, UA ia lehtëson karrierën ndërkombëtare stafit dhe studentëve të vet. Brenda Shqipërisë, UA kujdeset shumë për të promovuar punën artistike të studentëve dhe stafit të tij nëpërmjet performimit muzikor, produksioneve të operas dhe shfaqjeve, dhe ka galerinë e vet të artit që është e hapur për publikun. **[5.1; M10]** Në këto mënyra, ai është në gjendje të promovojë një kulturë të krijimtarisë artistike brenda vendit **[GID; 1.0 Ligji i përditësuar për arsimin e lartë 9741, 21 maj 2007; 1.12; 1.17; 1.20; 2.1.1; 2.1.2; 2.4.1; 3.1; 3.3] [Kapitulli II Standardi I.6; Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Rekrutimi i artistëve dhe interpretuesve të cilësisë më të lartë në vend për të mbështetur aktivitetin mësimor dhe kërkimor të UA (pika 4.5; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- Stafi akademik prodhon punë krijuese në nivel ndërkombëtar (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.1**)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim:

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim që është në progres.

Gjykim

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Pranimi i studentëve bëhet përmes procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes bazuar në kriteret që hartohen nga departamentet përkatëse dhe më pas miratohen nga Senati Akademik i UA-së dhe i dërgohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. [3:19; 3:20] Ministria e Arsimit dhe Sportit miraton kuotat e dërguara nga UA dhe nxjerr udhëzimet përkatëse për zhvillimin e përzgjedhjes së pranimit në bazë të rregulloreve dhe kriterëve të UA-së për këtë proces. Tarifat e shkollimit për çdo program studimi përcaktohen nga Ministri. Nuk ka zyrë qendrore këshillimore për studentët. Roli i kësaj zyre është ndërmarrë nga sekretariatë mësimore të fakulteteve dhe zyra e sektorit të mësimdhënies dhe informimit të studentëve. UA siguron informacione për kandidatët për pranim përmes mediave të ndryshme, përfshirë fletëpalosjet dhe faqen e vet të internetit. Në artet pamore aplikojnë rreth 20 persona për çdo kuotë. [M3; <http://www.UA.edu.al>] Stafit gjithashtu organizon një ditë informimi për studentët e mundshëm. Studentët aktualë ishin të qartë se informacioni i ofruar është i mirë, i saktë dhe i përshtatshëm dhe se procesi i aplikimit funksionon mirë. [Anketimi i studentëve, M5; M6] Kandidatët janë në gjendje të kërkojnë dhe të marrin përgjigje për çdo çështje të ngritur në kohë reale. Rekrutohen studentët nga territore jashtë Shqipërisë, siç është Kosova, dhe përvoja është po aq efikase, edhe pse ka një qasje paksa të ndryshme ndaj pranimeve. Informacione të mëtejshme janë të disponueshme nëpërmjet rrjeteve sociale. Fakultetet ofrojnë ndihmë për studentët në të gjitha fazat e regjistrimit [3.21; 5.5; M5; M6] Raporti i personelit akademik me kohë të plotë për student është 1:6.9, por institucionet e artit mbështeten shumë në stafin akademik me kohë të pjesshme, dhe kështu, duke marrë parasysh stafin me kohë të pjesshme, raporti i stafit akademik për student është 1:3.4 [GID, E3 dhe F1, fq.4-5; M3] [Kapitulli I Standardi III.1]

5.2 UA poston informacion thelbësor në faqen e vet të intranetit për studentët e tij. Kjo përfshin informacione të tilla si oraret mësimore, datat e provimeve, konkurset, njoftimet e fakultetit, seminare trajnimi, klasa model (*masterclasses*) dhe detyra kursi. Nëpërmjet këtij sistemi, studentët kanë një adresë email dhe një llogari private me detajet e tyre të identifikimit për shumicën e rezultateve të vlerësimit, edhe pse disa rezultate të vlerësimit janë dhënë para klasës për të mbështetur kritikën në grup. [5.1, 5.4; M5; M6]. Megjithatë studentët kanë adresa elektronike individuale, ata më shpesh përdorin mesazhet e shkurtra të telefonisë së lëvizshme për të kontaktuar lektorët e tyre. Studentët komentuan për komunikimin shumë të mirë me stafin dhe se mesazhet e shkurtra ofrojnë kontakt të menjëhershëm me të cilin ata janë të kënaqur. Studentët folën gjithashtu për mbështetjen e mirë individuale nga pedagogët që i trajtojnë ata si profesionistë të rinj. [M5] [Kapitulli I Standardi III.1]

5.3 Komunikimi i brendshëm bëhet përmes stendave të vendosura pranë sekretarive mësimore për çdo fakultet, si dhe përmes emailit të brendshëm. Organet drejtuese, stafi administrativ dhe stafi akademik në UA kanë adresa elektronike të brendshme personale [5.6; 5.8] Sekretariatë e fakultetit ruajnë dosjet personale të secilit student. [5.8; 5.9; M5; M6] [Kapitulli I Standardi III.2]

5.4 Gjatë studimeve të tyre studentët marrin mentorim nga lektorët e tyre. Në ditën e tyre të parë në UA, studentët i nënshtrohen një instruktimi i cili sqaron rregulloret dhe aksesin në shërbime. Përveç kësaj, ai përfshin prezantimin me stafin dhe një përmbledhje të plotë të lëndëve të tyre. Lektorët individualë shpjegojnë fushat, kërkesat dhe doracakun e programit. [M2; M11] Zyra e Shërbimeve të Karrierës së UA-së gjithashtu mbështet studentët. Klasat janë zakonisht të vogla dhe shpesh ka mësimdhënie individuale, të tilla si mësimi zanor që u jep studentëve një sasi të konsiderueshme të vëmendjes individuale. Një qasje gati si në konservator e kombinuar me këshilla praktike vazhdon përtej diplomimit. Studentët aktualë dhe të mëparshëm flasin mirë për marrëdhëniet e tyre individuale me lektorët dhe profesorët e tyre në këtë drejtim. [M5, M6, M8, M12] Kjo marrëdhënie individuale student / pedagog që vazhdon gjatë gjithë programit të studimit të çdo studenti dhe përtej diplomimit, ndërsa

artistët zhvillojnë karrierën e tyre, është një karakteristikë e **praktikës së mirë**. Ndërsa studentët zhvillohen, ata mund të përfshihen në punë kërkimore dhe / ose komisionet artistike të mentorëve të tyre. Ndërsa studentët shkojnë drejt diplomimit të tyre, ka një tranzicion përgjatë të cilit ata bëhen profesionistë. **[3.15; M5; M6; M12] [Kapitulli I Standardi III.2; Kapitulli I Standardi III.3]**

5.5 UA i drejton qartë studentët e vet gjatë gjithë kohës së tyre në institucion. Ai ofron broshura, njoftime në faqen e internetit dhe rrjetet sociale **[2.8.1; 5.3]** Mësimdhënia në internet dhe në letër dhe udhëzimet për informacionin e studentëve ofrojnë gjithashtu informacione dhe këshilla për studentët gjatë gjithë programit të tyre. Sekretariteti e fakultetit këshillojnë studentët të cilët mund të dëshirojnë të ndryshojnë programet e tyre të studimit. **[1.2 Kapitulli IV; 1.3 Kapitulli IV; 3.30; 3.31, 3.32] [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.6 UA mbështet studentët nga kategori të veçanta sociale përmes përjashtimeve nga tarifat e shkollimit. Kriteret për dhënien e bursave miratohen për çdo vit akademik. Bursat jepen si 100 për qind ose 50 për qind e tarifave të shkollimit. Studentët me aftësi të kufizuara janë një nga kategoritë që përjashtohen nga tarifat e shkollimit. UA ka gjithashtu një politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egjiptianë. **[5.11; 5.12; 5.13; 5.14; M2; M4]** Procedura për pranimin e secilit aplikant dhe miratimi i përfituesve është në përputhje me ligjin dhe rregulloret. **[1.2; 1.3; 1.1 Neni 57]** UA nuk ofron programe studimi me kohë të pjesshme dhe ka akses të kufizuar në objektet sportive. **[GID, E3 dhe F1; Anketimi i studentëve, 15.ix dhe 15.x; M5; M6] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.7 Biblioteka e UA-së është një burim i mirë i teksteve arsimore si në kopje fizike ashtu edhe në internet. Koleksioni është kataloguar sipas Standardeve ndërkombëtare. Biblioteka siguron gjithashtu një gamë të gjerë materialesh me interes të veçantë për studentët në programe të tilla si: muzikë (përfshirë libra, pjesë instrumentale, pjesë orkestrale, CD, libret, opera, pjesë vokale), drama (përfshirë libra, shfaqje, përkthime); dhe arte figurative (përfshirë libra, piktura, vizatime, grafikë, fotografi, qeramikë). **[4.6.1; 4.6.2; 4.6.3; 4.6.6; 5.15; M5, M6; M10]** Arkivi digjital siguron akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe përfshin film, regjistrime kasete, CD dhe DVD. **[5.17; 5.15; M10]** Shumica e studentëve e vlerësojnë ndihmën që ata marrin nga stafi i bibliotekës si të mirë ose shumë të mirë dhe gjithashtu janë të kënaqur me aksesin në tekstet e përshtatshme dhe materialet e tjera që mbështesin të nxëniet e tyre (shih gjithashtu pikën 2.9 më lart). **[Anketimi i studentëve, 13 dhe 14] [Kapitulli I Standardi III.5]**

5.8 Studentëve u ofrohet ndihmë dhe mbështetje sipas nevojës së tyre. Çdo lektor ndihmon dhe udhëzon studentët në ofrimin e literaturës së nevojshme, të lidhur me lëndën që ai ose ajo jep si pjesë e qasjes së mentorimit dhe zhvillimit të karrierës. **[3.25; M5; M6] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.9 Studentët janë të përfaqësuar në organet qeverisëse si Senati Akademik, këshillat e fakultetit dhe Këshilli i Administrimit, **[5.20; 5.21]** ku ata janë në gjendje të shprehin mendimet e tyre përmes përfaqësuesve të tyre në shumicën e aspekteve të institucionit që i prekin ata, siç janë kurrikula, studimet dhe ekspozitat. Për shembull, në një rast studentët kërkuan orë më të gjata në studiot e arteve të bukura, dhe në një tjetër ata kërkuan një shtyrje në afatin për një detyrë kursi në gjuhën angleze. Të dyja këto u miratuan. **[M5]** Studentët konfirmuan se zëri i tyre u dëgjua, edhe pse kjo shpesh ndodh në një format ballë-për-ballë në bisedë midis studentit dhe lektorit. **[M5; M6]** UA mirëpret krijimin e Këshillit të Studentëve, por është e paqartë se sa ndihmë financiare i kontribuon atij. Jo të gjithë studentët janë të vetëdijshëm për përfaqësimin në Këshillin Studentor, ndoshta sepse ata kanë mundësi të konsiderueshme dhe akses të drejtpërdrejtë në lektorët e tyre, gjë që i ndihmon ata të zgjidhin çështjet në nivel individual dhe shpejt, pa përshkallëzuar ankesat në ndonjë organ tjetër **[Anketimi i studentëve, 17 dhe 18, M5; M6] [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.10 Studentët u shprehën mbi dobinë e fokusit të përgjithshëm të UA-së. Ata e shohin frymëzues faktin që janë në një universitet ku kaq shumë krijimtari është e dukshme në mjedis. Përveç punës individuale në disiplina krijuese, ata punojnë së bashku, për shembull, në ekspozita, opera dhe filma. Këto mund të organizohen në kampusin kryesor, por edhe në Tiranë, rreth Shqipërisë dhe ndërkombëtarisht, shpesh me partnerë bashkëpunues. Studentët kanë mundësi të studiojnë në klasa dhe auditorë për më shumë se koha mësimore e tyre e drejtpërdrejtë. Jeta kulturore e studentëve është e dokumentuar mirë nga kalendarët e ngjarjeve të organizuara për çdo fakultet. Është e paqartë se sa UA bashkëpunon me strukturat shëndetësore për të promovuar nisma parandaluese dhe kurative për të ndihmuar shëndetin e studentëve. **[RVV fq.63; Anketimi i studentëve, 12; M1; M5; M6; M8] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.11 UA ofron mbështetje karriere nëpërmjet ndihmës së dhënë nga stafi akademik në bazë të kontakteve personale me shumë institucione, trupa arti dhe institucione të tjera publike ose private. Universiteti është i suksesshëm në ruajtjen e lidhjeve të forta me alumni, pjesërisht përmes mediave sociale. Në këtë mënyrë alumni shpesh ftohen në ngjarjet në UA-së dhe vlerësojnë përfshirjen e tyre të vazhdueshme në këtë komunitet krijues. Grupit të vlerësimit iu dëshmuua se Seksioni i Menaxhimit të Informacionit të UA-së ka filluar të mbledhë të dhënat e punësimit të alumni dhe statistikat përmes mediave sociale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** hapat që po ndërmerren nga Sektori i Menaxhimit të Informacionit të UA për të zhvilluar procesin aktual jo të plotë të mbledhjes së të dhënave të punësimit të alumni dhe statistikave për të përfshirë të gjithë studentët e diplomuar. Alumni janë shpesh individë që kanë qenë të suksesshëm në karrierën e tyre dhe kanë ndikim të konsiderueshëm si mentorë dhe modele për t'u ndjekur. **[M1; M5; M6; M8; M11; M12]** Ata i drejtohen UA-së kur kanë nevojë për punonjës ose komisione. Për shembull, në projektin e Qytetit të Arteve, studentët dhe alumni punuan së bashku. **[M1; M5; M6; M8; M11; M12]** Pjesët e performimit të studentëve shpesh mbahen në publik. UA punëson alumni që plotësojnë kriteret e kërkuara për programet e studimit. **[M11; M12]** Ka shembuj të punësimit të alumni si pedagogë me kohë të plotë, me kohë të pjesshme dhe lektorë të ftuar në të gjitha fakultetet. **[M1; M5; M6; M8; M11; M12]** Ndonëse Anketimi i studentëve nuk është krejtësisht pozitiv për ofrimin e mbështetjes formale të karrierës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi në vizitën në institucion që mentorimi individual dhe udhëzimet nga stafi individual ofruan mbështetje shumë të mirë të karrierës së vazhdueshme që nga koha e hyrjes së secilit student në UA deri në karrierën e tyre përtej studimeve të tyre. Mbështetja veçanërisht e mirë e karrierës, që ofron UA për studentët e vet, është një karakteristikë e praktikës së mirë. **[Anketimi i studentëve, 16.i, 16.ii, 16.iii, 16.iv] [Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Marrëdhëniet e mentorimit lektor/student individual që vazhdon gjatë gjithë programit të studimit të çdo student, edhe përtej diplomimit kur artistët zhvillojnë karrierën e tyre (pika 5.4; **Kapitulli I Standardi III.3**)
